Ida: Kështu mund të kontaktohem me më shumë njerëz, mund të ndihmojmë më shumë, dhe tek ne kontaktimet nuk janë problem, nga dita në ditë zgjerohet lista emërore. Vështirësia është, që kemi pak kohë për ndërtimin e grupit, por me një kursim të mirë të kohës, ashtu siç kemi mësuar gjatë këtyre viteve, ja dolëm mbarë të krijojmë një rrjet serioz që bazohet në bashkpuntorë të besueshëm dhe madhështorë. Duke u bazuar tek rezultatet jemi krenarë për ata!

Në grupin tuaj keni njëqind e pesëdhjet mjekë. A është edhe tek ata specifik ky organizim?

Ferenc: Po, ndoshta ka më shumë nga ata me punë paralele, sepse mjekët mësojnë dhe punojnë shumë, për tu bërë të suksesshëm në zanatin e tyre, prandaj e lënë atë me vështirësi. Por këtu nuk bëhet fjalë për ta lënë! Por fusha e mjeksisë nuk është punë, por profesion, një mjek i përkushtuar kujdeset për atë, që të rrisi njohuritë dhe të trajnojë veten.

Çfarë është ajo, që mësuat ndërkohë gjatë rrugës?

Ida: Me vendos objektiva. Unë isha menaxhere, atëhere kur nuk kisha akoma objektiv, thjesht nuk kisha vetbesim, nuk mendova, që edhe unë meritoj diçka. Me sukseset, vlerësimet, zhvillimin e personalitetit që ecën bashkë me ndërtimin e biznesit, tashmë jam në gjendje të ëndërroj, të vë objektiva dhe ti shkruaj ato.

Ferenc: Njerëzit vendosin me vështirësi objektiva, sepse nuk besojnë që jeta e tyre mund të jetë më shumë dhe më e mirë. Për këtë ata i kushtëzojnë kjo shoqëri, ky sistem shkollor. Ndërkohë ja vlen të besosh në të ardhmen: ne në derën e qilarit të shtëpisë që kishim si mjekë ngjitem fotot e dëshirave tona. Është interesante, që shtëpia që blemë atëhere, ngjan tmerrësisht me atë, që ëndërruam.

Ida: Çfarë vizualizon, atë realizon. Ne prandaj ja dolëm mbanë, sepse kishim një ëndërr: të merrnim kordonin e kuq nga Rex Maughan në vendin e takimit europian në skenën e Cannes. Dhe kështu ndodhi: për udhëtimin u kualifikuam në nivelin e tretë, dhe vetëm më vonë e morrëm vesh, që ka edhe nivel të parë dhe të dytë. Vetëm tani filluam të ëndërrojmë me të vërtetë, kur shikojmë që edhe kjo u realizua, edhe ajo u realizua...

Si ishte në Cannes?

Ferenc: Ishte e stuhishme. Më përpara grupmosha jonë nuk ka dalë shumë jashtë vendit, kështu që për ne ishte magjepsëse. Krahas kësaj njerëzit forcohen në të gjitha ngjarjet e mëdha, merr një siguresë më të re për atë, që është në vend të mirë.

Dhe ka, që edhe kordonin...

Ida: Po, ja dolëm mbanë. Është interesant, që kujt çfarë „i bie në kokë“, çfarë është ajë, që do ta vërë në lëvizje. Në grupin tonë ka, kush lufton tani për nivelin e menaxherit, sepse si program motivues i brendshëm mund të shkojë në Londër, të tjerët i motivon diçka tjetër, por shikoj atë, që askush nuk lëviz për para. Beson në diçka, fillon të veprojë, arrin objektivin, kjo i jep një vetbesim, që ka një forcë shtytëse pozitive përpara.

Si i zgjidhni bashkpuntorët tuaj?



Ida: Kërkojmë njerëzit e mirë, dhe jo në kuptimin e zanatit. Ata, që edhe nëpërmjet nesh jetojnë sipas normave standarte, në të cilët dominojnë gadishmëria për ndihmë, dashuria për njerëzit. Nëse dikush është i tillë, atëherë i mëson hapat e zanatit, por në të kundërt nuk ecën, sepse kjo është lojë grupi. Dhe ne kemi një grup shumë të mirë, me të vërtetë jemi të rrethuar nga njerëz të mirë.

Ferenc: Komuniteti është një forcë tërheqëse shumë e rëndësishme. Produkti sjell brenda njeriun, para e mban brenda, por për kënaqësinë e publikut do të jetë herët a vonë edhe antarë. Kjo mund të duket mirë edhe në zhvillimin tonë: në fillim u munduam të fusim njerëz me anë të produkteve, pastaj me të ardhurën pasive, ndërsa në vitet e fundit e vemë theksin për komunitetin, për ndërtimin e grupit, për përvojën e suksesit, për ndryshimin e personalitetit, dhe nga ajo kohë përparojmë me të vërtetë. Sigurisht nga kjo kushdo mund të zgjedhë çfarëdo nga tabakaja e Foreverit.

Ju vjen keq për vitet e humbura të fillimit?

Ida: Jo, kjo kurrë nuk më ka shkuar kështu ndër mend. Atëherë nuk kemi qenë të pjekur për atë: ky është një proces evolucionari. Njeriu duhet të sigurohet për atë, që a e ka vendosur shkallën në mur të mirë. Foreveri është një mur shumë i mirë, por për ta njohur atë duhet kohë. Për këtë arsye unë gjithmonë jam shumë e duruar me bashkpuntorët tanë: më vonë do të piquen për këtë!

Ferenc: Pjesërisht prandaj përparuam me këtë ritëm, sepse familja për ne ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme. Ndoshta po të jetonim vetëm të dy dhe çdo mbrëmje do të mbanim seminare, tani do të ishim safirë, por kjo nuk ka rëndësi. Edhe ana materiale prandaj duhet, vetëm për tu koncentruar në gjera të rëndësishme. Që të jemi në gjendje të ndihmojmë të tjerët, në rradhë të parë duhet të vemë në vend veten tonë. Por edhe atëherë do ti rekomandonim produktet, sikur të mos fitonim as një qindarkë prej tyre.

Për ty si nënë sa shtrohej pyetja, se për çfarë do ti sakrifikojë netët?

Ida: Për mua familja dhe fëmijët janë shumë të rëndësishëm. Atëherë jam me të vërtetë e lumtur, nëse udhëtojmë bashkë. Në fillim shumë herë kam patur keqardhje, që nuk isha shumë me

fëmijët. Pastaj e kuptova, kohën e lirë cilësore mund ta sigurojmë për ata me ndihmën e Foreverit, atë kohë të lirë, në të cilën mund të kujdesemi vetëm për ata si edhe dimë tu japim atyre 100 për qind të vetes tonë. Këta fëmijë rriten sipas vlerave të tjera, marrin modele të tjera, ndryshe nga një fëmijë i zakonshëm: të rinjtë e Foreverit nuk i shohim të humbin, përkundrazi shumë kanë arritur të jashtëzakonshme. Sepse edhe nga ajo, që mësojnë pa dashur nga ne, fitojnë shumë më tepër, bile do ta jetojnë jetën më vonë sipas një sistemi vlerash komplet ndryshe, nga ajo si e prindërve të zakonshëm që gjithmonë do ishin bashkë.

Ferenc: Vajzat tona të mëdhaja (20 dhe 16 vjeç, e vogla 10 vjeç) kanë tashmë mur objektivash. E dinë, që duhet punuar për suksesin dhe sakrifikuar: duhet mësuar, duhen lexuar librat, duhet zhvillim në personalitet. Përdorin produktet, dhe kur e shohin që udhëtojmë, brenda tyre është ajo, që njëherë edhe ato duan ta përfetojnë këtë. Do të dëshiroja, që të jenë ndërtues rrjeti, sepse pavarësisht nga vështirësitë jep aq shumë, ndoshta sa asgjë tjetër.

Cili është tani objektivi juaj kryesor?

Ferenc: Të stabilizojmë grupin tonë dhe të marrim çekun tonë të parë Chairman's Bonus. Me siguri që do ta marrim, sepse jemi shumë mirë me raportin kohor, dhe grupi po rritet. Pas nivelit të menaxherit i dhamë vetes kohë dy vjet deri në nivelin e seniorit, tani punojmë për nivelin e soaringut, dhe po e shikoj, që këtë vit edhe do ta arrijmë. Veç kësaj dëshiroj të bëhem edhe për të tretën herë Senior Eagle menaxher dhe me tre Eagle menaxherët tanë të rinjë të shkojmë në Amerikë, në Lake Tahoe. Dëshira jonë është, që të mos shkojmë vetëm, por me bashkpuntorët tanë, sepse në sukseset tona, vetëm sukseset e „fëmijëve tanë” janë më frymëzueset!

Ida: Nganjëherë është e vështirë për të mbajtur objektivin, por e besoj, që po të mësojmë, po të zhvillohemi, investojmë energji për të ndryshuar, atëherë suksesi ynë në biznes nuk do të vonojë. Ndërtojmë një komunitet të tillë, ku njerëzit mësojnë të ëndërrojnë, të besojnë, të punojnë për objektivat, në të cilat ju rritet besimi nga dita në ditë, dhe me këtë janë në gjendje të krijojnë gjëra më të mëdhaja dhe më të mira.

lifestyle

Këshilla për mënyrën e jetesës



Sëmundjet e ezofagut



ÇRREGULLIME TË ZHVILLIMIT

Nuk janë të rralla, një në çdo 3000-4500 lindje.

- atresia e ezofagut: ezofagu përfundon i mbyllur
- kalim fistule midis ezofagut dhe laringut
- ngushtim i lindur i ezofagut
- dopio ezofag
- unaza dhe diafragma të ezofagut
- gjerime të ezofagut

Sëmundje refluksi Gastrooesophagealis (GORB)

probleme të tjera të lëvizjes të ezofagut

Sëmundje inflamative të ezofagut: nyelócső : myke, viruse, bakterie, parazitë, që mund të shkaktohen edhe nga ilaçet.

Dëmtime të ezofagut

Tumore të ezofagut

Sëmundje funksionale të ezofagut

Duke u nisur nga karakteristikat e sëmundjeve të popullsisë duket se sëmundjet e ezofagut janë në shtim

Sëmundjet e laringut i përshkruan për herë të parë Dr. A.

Winkenstein më 1935 i cili analizon varësinë midis membranës të gëlltitjes të ezofagut dhe efektit dëmtues të lëngut të stomakut.

Ndërsa emërtimi reflux oesophagitis (refluku i ezofagut) e ka origjinën nga Dr. Allison i cili studjoi mekanizmin e refluksit (rrjedhjen e kundërt) dhe rolin e tij në dëmtimin e membranës të gëlltitjes.

Shpjegimi i disa termave:

Refluksi i ezofagut do të thotë që përmbajtja e stomakut nga lëvizja në drejtimin normal të kthehet në të kundërt në lumenin e ezofagut. Në shumicën e rasteve përmbajtja e stomakut është acide dhe në raste të rralla në formë alkaline dhe vveri. Refluksi i ezofagut mund ti ndodhë kujtëdo, por në shumicën e rasteve kjo nuk shkakton deformim apo dhimbje.

Refluxi oesophagitis, do të thotë inflamacion i membranës të gëlltitjes të ezofagut, ku si rrjedhim ndodh kthimi mbrapsht i përmbajtjes të stomakut. Inflamacionin e ezofagut mund



ta shkaktojnë shumë faktorë si : pirja e ilaçeve, viruset, bakteriet, myket dhe lëngjet me efekt djegës. Sëmundjet e Refluktës Gastro-Oesophagealis (SRGO) – janë tërësia e dhimbjeve dhe simptomave si rrjedhim i të cilave ndodh kthimi mbrapsht i përmbajtjes të stomakut. SRGO janë një nga defektet më të shpeshta të sistemit tretës, një nga sëmundjet që varet nga aciditeti. Në popullsinë e rritur hungareze 55% vuan nga një nga këto simptoma, ndërsa 7% e popullsisë çdo ditë ka djegie të stomakut. Nga gratë me barrë 48% e tyre ankohet nga simptoma të ngjashme.

Mekanizmi i zhvillimit të sëmundjeve të ezofagut (SRGO):

Baza e sëmundjes është lëvizja e ndryshueshme, pra e sëmurë e ezofagut. Si rrjedhim i kësaj përmbajtja e stomakut kthehet mbrapsht në ezofag, nga ku si rrjedhim i problemeve të lëvizjes, zgjatet zbrazja e përmbajtjes acidore të stomakut për shkak të kohës të kalimit tranzit në ezofagun e zgjatur. Acidi dëmton aftësinë mbrojtëse të membranës të ezofagut dhe për rrjedhim keqsohet edhe më tej aftësia lëvizëse e ezofagut të sëmurë. Fillon kështu rrethi i djallit ku njeri dëmtrim shkakton tjetrin. Në kushte normale, gjatë gëlltimit, vala peristaltike e ezofagut shkon deri në fund. Lumeni para kafshatës të ezofagut lirohet, tërhiqet pas dhe shtyn përpara ushqimin. Kur kafshata arrin para grykës të stomakut, muskuli bllokues i poshtëm i ezofagut që është në formë unaze (lower esophageal sphincter – LES) lirohet dhe lejon ushqimin në stomak. Procesin e rregullon sistemi nervor vegetativ. Këtë funksionim jashtzakonisht të koordinuar, mund ta prishin shumë gjëra si psh: gjendja nervore, hormonet, ilaçet, ushqimet. Pra element i rëndësishëm i lëvizjes jo normale të ezofagut është ajo që:

- ndryshon funksionimi normal i unazës bllokuese të poshtme të ezofagut,
- ndryshon koha e procesit të pastrimit të ezofagut, e ashtuquajtura „clearance”.

Në qoftë se lëvizjen peristaltike e bën stomaku, rritet presioni në të, dhe bashkë me të edhe në rastin normal rritet edhe presioni LES, që mbron ezofagun. Megjithatë ky sistem mbrojtës nuk është i përkryer, kështu edhe tek individë të shëndetshëm, çdo ditë ka shumë raste të refluktës, por megjithatë kjo nuk shkakton inflamacionin e

ezofagut. Kusht i inflamacionit të ezofagut me bazë refluktës është ajo që presioni LES të jetë vazhdimisht i ulët. Presionin e muskulit bllokues mund ta dobësojnë përdorimi i disa lloj ilaçesh apo ushqimesh. Yndyra, gjalpi kakao (çokollata), alkoli, kafeina dhe nikotina, të gjitha kontribuojnë në uljen e aftësisë bllokuese. Pra bazë e lindjes të sëmundjes të refluktës, është lëvizja jo normale e ezofagut, por faktor përcaktues që çon në dëmtimin e membranës është aciditeti agresiv i stomakut.

Simptomat e sëmundjes të refluktës të ezofagut:

- Simptoma më e shpeshtë është djegja e stomakut. Në rastet më tipike ajo ndihet si djegie pas kockës të krahavorit. Kjo ndihet gjatë pëkuljes apo shtrirjes dhe shfaqet disa orë pas ngrënies. Gjella e nxehtë apo e ftohtë dhe pijet shkaktojnë dhimbje të menjëhershme. Shpesh një sasi e vogël e ushqimit kthehet nga stomaku në gojë.
- Inflamacioni mushkrive, bronkit, azma: rrjedhje e kundërt e përmbajtjes të stomakut gjatë gjumit që vështirëson rrugët e frymëmarrjes. Mund të shfaqen gjithashtu kollitja, frymëmarrja e vështirë, ngjirja.
- Dhimbje e fortë me karakter djegës e kafazit të krahavorit, që shumë herë është e vështirë ta dallosh nga dhimbjet e anginave apo të zemrës.
- Vështirësi gëlltitive: si rrjedhim i ngushtimit të ezofagut shfaqen



komplikacione të inflamacionit të tij.

Simptomat e sëmundjes të refluktës të ezofagut në moshën foshnjore dhe fëmijore, në thelb ndryshojnë nga format e të rriturve. Tek moshë fëmijore më tepër dalin në plan të parë ankimet për organet e frymëmarrjes. Karakteristike mund të jetë edhe anemia nga mungesa e hekurit, ndërprerja e rritjes të fëmijës, „kthimi i qafës së shtrembër” (foshnja në krevat merr një pozicion të tillë të trupit, sikur do të ketë më pak refluktës).

Komplikacionet e inflamacionit të ezofagut me reflux :

- ngushtim: 8-20%
- krijim shtresash ulceroze: 5%
- deformacion i diafragmës që krijon refluktës: 8-20%
- hemoragji: 2%.

Diagnostikimi i sëmundjeve të ezofagut:

- Analiza me Rtg. me kontrast (nqse dyshohet për ngushtim të ezofagut)

lifestyle

- Analiza endoskopike

Për dëmtimin dhe ndryshimet e membranës të gëlltitjes na sqaron bërja e biopsisë.

Kurimi i sëmundjeve të ezofagut

- Dieta: paksimi në minimum i yndyrës, çokollatës, alkolit, gjellëve pikante dhe kofeinës

- Ndryshim i mënyrës të të jetuarit:

- ngritja e kokës të krevatit,

- shmangja e veshjes të rrobave të ngushta të barkut (pra pakësim i presionit ndaj barkut), për këtë të fundit duhet arritur në uljen e peshës trupore. Për këtë një plotësues i mirë dietik janë acidi hidroksil-citrik dhe produktet me fikusin e detit dhe fasulen e bardhë.

- Evitimi i ngrënies në orët e vona

- Lënia e duhanit

- Farmacisti

- Kirurgu

Janë me interes edhe studimet e bëra me këngëtarët e operave.

Ka rezultuar se presioni i zgavrës të barkut që rritet gjatë të kënduarit rrit shpeshtësinë e simptomave të refluksit si rrjedhim i kthimit mbrapsht të acidit të stomakut, por edhe ngjirja e zerit ishte më e shpeshtë se sa tek grupi i kontrollit. Në rastin e atyre të instrumentave të orkestrës frymore refluksi i acidit ishte gjithashtu më i shpeshtë se sa tek grupi i kontrollit, më i shpeshtë ishte gjithashtu djegja e stomakut, por jo në masë të rëndësishme. Kuptohet që refluksi i ezofagut tek këngëtarët e operave dhe muzikantët e orkestrave frymore është sëmundje që lidhet me profesionin.


Firmat farmaceutike ofrojnë një numer ilaçesh për bllokimin e acidit dhe përmirësimin e tretjes. Shumë vetë i përdorin ato pa kufizim, ndërsa zgjidhja është e thjeshtë.



Hippokrati thotë: „Do të bëhesh ai, çfarë ha !”

Ndërsa Seneca thotë: „Njerzit gjëmojnë varrin e vet me dhembët e tyre!”

Dr. István Mokánszki
Patholog – Gastroenterolog
Menaxher



Karakteristikë e ushqyerjes të njerzve të sotëm është konsumimi i ushqimeve të gatshme e gjysëm të gatshme, i fastfudeve që shkaktajnë dhjamosje ndërkohë që mungojnë përbërësit e rëndësishëm për jetën e shëndetshme.

Këtyre u shtohet konsumi i tepërt i embëlsirave, si dhe i alkolit e pijeve të gazuara.

Përsëri mund të citojmë Hippokratin: „Vdekja banon tek zorrët !”

LITERATURA

- Dr. Herszényi László
Savfüggő kórkepek.
Magyar Belorvosi Archivum. 2009/3

- Dr. Herszényi László és társai
A Gastrooesophagealis refluxus tünetek gyakorisága operaénekesekben és fűvósokban.
Magyar Belorvosi Archivum 2008/3.

- Dr. Lonovics János, Dr. Tulassay Zsolt, Dr. Varró Vince
Klinikai Gastroenterológia 2003.

- Dr. Pandolfino J.E. és társai
Az elhízás veszélyezteteti a nyelő-gyomor átmenet épségét
Gastroenterologi 2006.

- Heider T.R. és társai
A funduplicatio javítja a nyelőcső rendellenes motilitását
Gastroenterologi 2004. február

- Dr. Tulassay Zsolt
A nyelőcső reflux és kezelése

Periudha e kualifikimit: nga 1 Shtator 2013 deri në 31 Dhjetor 2013.

KUSH MUND TË KUALIFIKOHET?

Çdo distributor i ri apo i vjetër, që nga niveli aktual ngjitet të paktën një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga shkalla e distributorit mund të kualifikohesh vetëm në qoftë se arrin shkallën e supervizorit). Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!

CILAT JANË KUSHTET E NEVOJSHMETË KUALIFIKIMIT PËR KËTË PROGRAM STIMULIMI?

Ngjit shkallën! Gjatë periudhës të jesh Aktiv (pra 4 pikë, nga të cilat 1 pikë të jetë në emrin e vetë) që nga muaji i parë i plotë, domethënë në qoftë se je regjistruar në 15 Tetor 2012, atëhere nga 1 Nëntori. Në krahasim me nivelin tënd ekzistues duhet që në planin e marketingut të ngjitesh një shkallë (ata që janë në nivel distributori duhet të arrijnë nivelin supervizor). Ky është Niveli i I-rë i Holiday Rally-it. Pas kualifikimit, deri në fund të periudhës të kualifikimit përsëri duhet të plotësosh në dy muaj të njëpasnjëshëm kushtet e kualifikimit, domethënë për shembull nga niveli i distributorit ose asistent supervizorit arrite nivelin supervizor në Mars, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e Tetor dhe Nëntor të marra së bashku dhe Nëntori me Dhjetorin bashkë duhet të jenë përsëri 25 pikë. Në qoftë se nisësh nga shkalla e supervizorit dhe arrite shkallën asistent menaxher në Tetor, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e Tetorit dhe Nëntorit së bashku si dhe e Nëntorit me Dhjetorin së bashku duhet të jetë përsëri 75 pikë dhe kështu me radhë: në kualifikimin për nivelin e II-të të programit Holiday Rally. Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit dhe ke plotësuar kushtet e kualifikimit për Holiday Rally, atëhere në Holiday Rally nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por sigurisht je kualifikuar për nivelin e I-rë. Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ngjit dy a më shumë shkallë të planit të marketingut, ai në Holiday Rally merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra ka arritur nivelin e II-të.

AKOMODIMI:

Në hotelin me 5 yje „Ambasador”, të gjitha përfshi. Bashkpunëtorët e kualifikuar për Nivelin e II-të do të shkojnë me autobus VIP, dhe gjatë aktivitetit do tu shërbehet në bufe VIP-ash dhe nuk do të ketë pika shitje për VIP-a duke mos pritur në radhë. Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

KUR DHE KU DO TË JETË HOLIDAY RALLY?

3-4 Tetor 2014, në Opatija të Kroacisë.



HOLIDAY RALLY
Opatija



NJOFTIME TË ZYRËS QËNDRORE

Me zyrat tona mund të lidheni në faqen e Internetit të distributorit në adresën www.foreverliving.com duke klikuar „FORGALMAZÓI BEJELENTKEZÉS”. (Për tu futur në të duhet passwordi dhe emri i përdoruesit, të cilat mund ti siguronit duke dërguar një e-mail tek qendra e informatikës me adresë: it@flpseeu.hu. Këtu mund të gjeni informacion për gjëndjen e pikëve, për blerjen me internet dhe për llogaritjen e bonusit mujor. Këtu mund të gjenden gjithashtu materiale marketingu, revista mujore, ditari aktivitetesh, përshkrimi i programeve stimuluese, materiale që mund të shkarkohen nga interneti, materiale trainimi, katalogë, politikën e biznesit të FLP et. Kanalet tona YouTube, mund ti gjeni në adresën www.youtube.com/user/AloePod



HUNGARIA

Drejtoria Qëndrore Budapest: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11.
E-mail: flpbudapest@flpseeu.hu Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289, +36 1 297 1995 Me korespondencë me letër: 1439 Budapest, Pf.:745.
Drejtori përgjithshëm: Dr. Sándor Milesz: +36 1 297 1995, mobil: +36 70 316 0002
Drejtoreshë e Marketingut dhe e Komunikimit: Bernadett Huszti: ext:194, mobil: +36-70-436-4212;
Dóra Harman: ext: 157, mobil: + 36 70 436 4197
Zsuzsanna Petrőczy: ext: 131, mobil: +36-70-436-4276
Derjtoresha e shitjeve dhe e zhvillimit: Erzsébet Ladák: tel.: +36-1-269-5370/ ext.160, mobil: +36-70-436-4230;
Seksioni i komunikimit ndërkombëtar: Aranka Szecsei: ext. 136, mobil: +36 70 436 4229; Otília Csábrádi: ext. 135, mobil: +36 70 436 4227
Seksioni i Marketingut dhe Trainimit (FLP TV): Sándor Berkes, ext. 133, mobil: +36 70 436 4213

Qendra e Trainimit: 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel.: +36-1-332-5956, +36-70-436-4285, +36-1- 373-0025, fax: + 36-1-312-8455
Prenotimi sallës/ informacioni: Bálint Rókás mobil: + 36 70 436 4280
Hapur: H-P: 10.00-21.00

Qendra e Trainimit SONYA Koordinimi i kohës: Veronika Kozma - kozmetiste: +36 70 436 4208; Melinda Ésik - parukere : +36 70 436 4178
Skonto shërbimi: me 10 herë 10%, me 5 herë 5%
TRAINIM FALAS në Qendrën e Trainimit Sonya! Në rrugën Szondi të martën e l-rë të do muaji në orën 10, ndërsa në rrugën Nefelejcs, në qendrën Sonya, çdo të martë dhe të enjte lidhuni me telefonin e Foreverit: Kata Ungár 30-331-1883.

Produktet e Forever Living Products shiten me rekomandim të Shoqatës Hungareze të Mjekësi Alternative.
Produktet tona mund të blihen ose porositen personalisht në përfaqsitë tona

POROSIA E PRODUKTEVE

Me telefon në telecentrën tonë:

Të hënën 8-20, të martën deri të premten 10-20:
Tel.: +36-1-297-5538, +36-1-297-5539, mobil: +36-70-436-4290, +36-70-436-4291

Të hënën 12-20, të martën deri të premten 10-18 :
Cel: +36-70-436-4294, +36-70-436-4295

të hënën deri të premten 12-16:
Pa pagesë mund të kërkoni në linjën: +36-80-204-983
Adresa e-mail e telecentrës: telecenter@flpseeu.hu

Shitje me Internet

www.foreverliving.com ose www.flpshop.hu
Për të kontaktuar me shërbimin e klientit në Internet:
tel: +36-22-333-167, +36-22-500-020, +36-70-436-4286,
e-mail: webshop@flpseeu.hu

Përgjegjëse e shërbimit ndaj klientit në telecentër dhe internet:
Melinda Malik Melinda, Cel: +36-70-436-4240

produktet e porositura me telecentër ose internet ju vijnë me korier brenda 2 ditësh, duke ua sjellë në shtëpi. Për blerjet 1 CC e lartë shpenzimet e transportit i mbulon firma.

RISHITJA E PRODUKTEVE DHE REKLAMA Produktet dhe materialet tona të marketingut është e ndaluar të rishiten në internet. Ato mund të ekspozohen dhe shiten në dyqane dhe zyra në bazë të pikave 16.02 (h), (i), (j) dhe (k) të politikës së FLP. Rregullat që kanë të bëjnë reklamën dhe përgatitjen e faqes personale të internetit që lidhen me veprimtarinë e distributorit mund ti gjeni në pikat 16.02. (h), si dhe 17.10 të Politikës të FLP. Për të DHËNAT E XHIROS mund të interesohi si më poshtë:

– në internet: në pjesën e distributorit të faqes: www.foreverliving.com,
– në softwerin Forever Telefon, – me shërbimin internet MyFLPBiz,
– dhe qendrat tona: për partnerët e Hungarisë në numerat telefonik: +36-1-269-5370 dhe +36-1-269- 5371 ndërsa për vendet e tjera të rajonit tonë në: +36-1-332-5541. +36-1-269-5370 dhe +36-1-269-5371, kurse nga shtetet e tjera të rajonit në numrin +36-1-332-5541.

Drejtoria Operative: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11. Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289

Derjtori i Përgjithshëm i Menaxhimit: Péter Lenkey: cel: +36-70-436-4292
Asistente: Mónika Vékás-Kovács: ext. 192, cel. +36 70 436 4281
Derjtoresha e Financës: Gabriella Rókásné Véber: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 171, Cel: +36-70-436-4220
Shefe e financës: Katalin Blahut Botosné: ext. 121, Cel: +36 70 436 4218
Derjtori i Kontrollit: Zsolt Suplicz: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 181, Cel: +36-70-436 4194,
Orari i hapjes dhe shërbimit ndaj klientit në magazinat e Rrugës Nefelejcs: H: 8-20, M-E: 10-20, P: 10-18,
Në ditët e punës të çdo fund muaji 8-20,
Përgjegjëse e shërbimit ndaj klientit: Melinda Malik Cel: +36-70-436-4240

Derjtoria e Rajonit të Debrecenit: 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48. Tel.: +36-52-349-657, fax: +36-52-349-187 Hapur: Hënën: ora 12-20, të martë-premte: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)
Derjtori Rajonal: Kálmán Pósa: Cel: +36-70-436-4265

Derjtoria Rajonale e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., Tel.: +36-62-425-505, fax: +36-62-425-342 Hapur: H: 12-20, M – P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)
Derjtori Rajonal: Tibor: Radóczy

Derjtoria Rajonale e Székesfehérvárit: 8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3. Tel.: +36-22-333-167, +36-70-436-4286, +36-22-500-020, fax: +36-22-503-913 Hapur: H: 12-20, M– P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës) Derjtori Rajonal: Tibor Kiss.
Hapja për raste të veçanta: Shitja dhe porosia e produkteve në përfaqsitë dhe telecentrën e Hungarisë mund të bëhet edhe të Shtunën e fundit të muajit kur pas saj nuk ka më ditë pune nga ora 12 deri 20. Në këto raste orari i saktë shpallet edhe në faqet e internetit dhe në përfaqsitë tona.

Forever Resorts Teleki-Degenfeld Kastélyszálló, Szirák, 3044 Szirák, Petőfi u. 26., tel.: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285 www.kastelyszirak.hu
Restoranti Sasfészek, tel.: +36-1-291-5474, www.sasfeszeketterem.hu.
Derjtoresha e Resortave të Foreverit në Hungari Katalin Király.
Zyra Phoenix për prenotim bileta avioni Szondi u.: H-P: 12.00-18.00, Gabriella Pittmann +36 70436 4297

Mjekët tanë specialistë: Dr Edit Révész Siklósné, kryetare e Mjekëve Specialistë të Forever Hungari, Dr. Gabriella Kassai: 70/414-2335; Dr. László Mezősi: 70/779- 1943; Dr. Endre Németh: 70/389-1746; Dr. Terézia Samu: 70/627-5678, Mjek specialist i pavarur: Dr. György Bakanek: 70/414-2913
Mund të thirrren gjatë orarit të punës.

KALENDARI AKTIVITETEVE: Budapest, Success Day: 17 nëntor dhe 15 dhjetor 2012.

PROGRAMI TRAINIMIT VJETOR 2013

DITË SUKSESI: 20 korrik, 16 nëntor;

TRAINIME 2 DITOR: 8-9 qershor, 12-13 tetor

PROGRAMET STIMULUESE

15-22 shtator trainimi Go Diamond, 4-5 tetor Holiday Rally

NJOFTIME



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11010 Beograd, Kumodraška 162.
tel.: +381 11 397 0127, Fax: +381 11 397 0126,
e-mail: office@flp.co.rs
Dërgimi porosive: narucivanje@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 12.00–19.30,
Të mërkurë dhe të premte 09.00–16.30,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit
9.00–12.30 Telecenter: +381 (0) 11 309 6382
Salloni i Bukurisë Sonya: 063/394 171

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 1/3, Tel: +381 (0) 18 514 131; Fax: +381 18 514 130, e-mail: officenis@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 11.00–19.00
Të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit
9.00–12.30

Zyra Horgosi: Tel/fax: +381 (0) 24 792 195,
e-mail: tinde.szolnoki@flp.co.rs
Hapur: nga e hëna deri të premten: 8.00–16.00.
Çdo të shtunë të fundit të muajit: 9.00–12.30.

Drejtor rajonal: Branislav Rajić
Mjekët Specialistë: Dr. Biserka Lazarević
dhe Dr. Predrag Lazarević: +381 23 543 318

Success Day: 27 janar, 24 mars, 19 maj, 23 qershor
29 shtator, 24 nëntor



MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica,
Serdara Jola Piletića 20.,
tel: +382 20 245 402 fax: +382 20 245 412
Hapur: të hënë: 12.00–20.00
Ditët e tjera të punës: 9.00–17.00
Çdo të shtunë të fundit të muajit, hapur nga 9.00–14.00

Drejtori Rajonal: Aleksandar Dakić
Mjeku specialist: Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127
flppodgorica@t-com.me



SLLOVENIA

Zyra e Lubljanës: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3.
tel.: +386 1 562 3640, fax: +386 1 562 3645
Porosi e produkteve: Cel: +386 40 559 631,
tel: +386 1 563 7501
Porosi me e-mail : narocanje@forever.si
Informacione me e-mail : info@forever.si
Hapur: hënë 12.00–20.00, të martën deri të premten
9.00–17.00

Zyra e Lendvai: 9220 Lendava, Kolodvorska 14.
tel.: +386 2 575 12 70, fax: +386 2 575 12 71
Hapur: të hënë deri të premten 9.00–17.00
e-mail: lendva@forever.si
Drejtori Rajonal: Andrej Kepe
mjeku specialist: Dr. Miran Arbeiter: +386 41 420 788
Success Day: 23 mars, 18 maj, 28 shtator, 23 nëntor
Trainime: Leksione të hapura çdo të mërkurë nga ora 19.00,
Draš Center, Maribor, Pohorska 57.



KROACI

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.
tel: +385 1 3909 770; 3909773 dhe 3909775, Fax: +385 1 3909 776
Hapja gjatë verës (nga 1.7.2013 deri 2.9.2013
të hënë dhe të enjte: 12.00–20.00,
të martë, mërkurë dhe premte 09.00–17.00

Zyra e Rjekës: 51000 Rijeka, Strossmayerova 3/A
tel: +385 51 372 361,
Hapur: të hënë dhe të enjte : 12.00–20.00,
të martë, të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00
Drejtori Rajonal : Dr. László Molnár
Mjekët specialistë: Dr. Ljuba Rauški Naglič: mobil: +385 91 51 76 510
në ditët teke: 16.00–20.00, Dr. Draško Tomljanović:
mobil: +385 91 41 96 101 të martën 14.00–17.00 dhe të premte
14.00–16.00

Trainime: Zagreb, dhe Rijeka, të hënë dhe të enjte nga ora 18.00
Adresa e Internetit: www.foreverliving.com – përgjigja në gjuhën kroate,
në këtë faqe mund të shiten edhe produktet

Success Day: 23 mars Zagre, 18 maj Opatij, 19 tetor Opatij– Hotel Adriatik



SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Tiranë, Fuat Toptani 1/5.
Tel./Fax: +355 44 500 866
Hapur: ditët e punës 9.00–13.00 dhe 16.00–20.00
Drejtor Rajonal: Attila Borbáth
cel: +355 69 40 66 810, +36 70 436 4293
Shef Zyre: Xhelo Kiçaj: Cel: +355 69 40 66 811,
e-mail: flpalbania@abcom.al



KOSOVA

Zyra e Prishtinës: Prishtinë Rr. Azem Hajdari br. 32.
tel.: +377 44 50 3911
hapur gjatë ditëve të punës: 10.00–16.00.
Derjtor rajonal: Attila Borbáth
Cel: + + 355 69 40 66 810

flpkosova@kujtesa.com



BOSNJE-HERCEGOVINA

Zyra e Bijeljinas: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.
tel.: +387 55 211 784, +387 55 212 605, fax: +387 55 221 780
Hapur gjatë ditëve të punës 9.00–17.00
Derjtor rajonal: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevos: 71000 Sarajevo, Džemala Bijedića 166 A.
tel.: +387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651
Hapur: të hënë, enjte dhe të premten 09.00–16.30,
të martën dhe të mërkurën: 12.00–20.00
Shef Zyre : Enra Ćurovac-Hadžović
forever.flpbos@gmail.com,

Success Day: 1 qershor Sarajev, 7 dhjetor Bijeljin

FOREVER

ELEONÓRA BARANYI DHE JÓZSEF BARANYI MENAXHERË

Shumë shpejt, brenda katër muajve u bëtë menaxherë. Si filloi historia juaj?

Në fillim të shkurtit sponsori ynë na prezantoi Foreverin, dhe ndonëse produktet i konsumojmë prej pesë vjetësh, nuk e njihnim mundësinë ekonomike dhe të ndërtimit të rrjetit që të ofrohet nëpërmjet Foreverit. Reagimi im i parë ishte kundërshtimi, sepse nuk kisha dëshirë të merresha me rekomandimin e produkteve. Por ajo mundësi, që mund të ndihmojë të tjerët, si në ruajtjen e shëndetit ashtu edhe në zhvillimin e biznesit, ishte me të vërtetë tërheqëse dhe tek kjo gjeta veten. Cilësia e lartë e produkteve ishte bindëse. Si mjeke alternative njoh një sasi të konsiderueshme produktesh, p.sh. përgatitja e Vitolize-s është e tillë, sikur ta kisha ndërtuar unë: në ambulancën time kam provuar me përbërës të ngjashëm të rregulloj cilësinë e jetës së pacientëve të mi. Kam një bashkëshort fantastik, pa të cilin nuk do të funksiononte biznesi. Në të gjitha vendimet është pranë meje. Më shikon, dhe më pyet, që a do të eci, ndërsa unë i përgjigjem: po! Unë jam ëndërruesja, ndërsa ai është ai, që mbështet realizimin e këtyre ëndrrave. Është shumë i vendosur. Për atë duhej vetëm pesë ditë, që pas "bluarjes" me themel të politikës së biznesit të bindej, që Foreveri është një dhurues fantastik sigurie, është një sipërmarrje serioze.

Cilat ishin hapat e fillimit?

Me qënë se për shumë kohë kemi qënë sipërmarrës të suksesshëm, u nisëm shumë shpejt, ju vumë me të gjitha forcat. Brenda katër muajve u bëmë menaxherë, por këtë e kishim edhe si qëllim, sepse nga këtë fillon puna e vërtetë. Mundohemi që gjatë ditëve të javës punën ekzistuese ta koordinojmë me Foreverin, ndërsa nga shtatori dëshiroj që të merrem me këtë më me forcë. Hapi i parë ishte mbyllja e dyqanit tonë bio, dhe në vend të tij hapëm Zyrën e parë Informative të Aloes (për hapjen e AloelInfoCentar kemi folur në numrin e revistës paraardhëse - red.). Me këtë kemi bërë që unë si angazhim kryesor të ditës të kem Foreverin. I kemi vënë theksin sigurimit të vëndeve të reja të punës prandaj edhe kemi shpallur mundësitë e veçanta të punësimit në këtë biznes si dhe ditët e sipërmarrjes.

OBJEKTIV ËSHTË DIAMANTI!

Çifti nga Subotica në shkurtin e këtij viti hodhi votën për Foreverit. Kanë dy vajza, më e vogla, Dolores që tani pesëmbëdhjet vjeç përgatitet me vetëdije për jetën e ndërtuesit të rrjetit. Pyetëm Eleonorën për karrierën e deritanishme dhe për objektivat e të ardhmes.

Szponzor: Molnár Rudolf és Molnár Ildikó

Felsővonal: Radóczy Tibor és dr. Gurka Ilona, dr. Miliesz Sándor, Rex Maughan

: „Më ndiq, dhe do ta tregoj,
se si do të mund të arrish më shumë se unë!”

Cilat janë planet tuaja për këtë vit?

Më e rëndësishmja është zgjerimi i rrjetit, dëshiroj ta ndryshoj, ta lehtësoj. Të regjistruarve të rinjë është e rëndësishme t'ju thuhet të gjitha ato gjëra, me të cilat duhet të përballen një ndërtues i ri rrjeti. Do të doja të siguroja për grupin trajnim më të efektshëm dhe më të shpejtë. Vetëzhvillimi, vetëtrajtimi i vazhdueshëm janë ato fusha, për të cilat i mësojmë antarët e grupit, dhe e konsiderojmë të domosdoshme pjesëmarrjen në Ditët e Suksesit. Si sponsor e quajmë një gjë të rëndësishme, që të ecim në gjurmët e njohurive të përvetësuar nëpërmjet bashkpuntorëve tanë, dhe si rezultat i kësaj mund të punojmë më me efektshmëri. Përpiqemi të transmetojmë entuziazmin dhe besimin tonë. Qëllimi ynë është të shndrohemi në drejtues të mirë, dhe detyrimi i parë brenda kësaj, që edhe ne vetë të jemi më të suksesshëm, kështu grupin tonë mund ta drejtojmë me hapa të sigurt drejt suksesit.

Njëherë po mbetemi në Serbi, por nuk është e mbyllur, që së shpejti të hapemi edhe jashtë saj. Në të ardhmen dua të hap një zyrë të re informative në qendër të qytetit, ku do të ketë vend për trajnime, kurse dhe prezantime. Këtu bashkpuntorët mund të punojnë me potencialin e tyre të kandidatëve në një sipërfaqe pak më të madhe. Për ne objektivi është niveli i Diamant Menaxherit, dhe jam i sigurt, që me këtë besim dhe vendosmëri do ta arrijmë brenda një periudhe të shkurtër.

Në çfarë ndryshuan ditët tuaja gjatë këtyre muajve të fundit?

Jeta jonë ndryshoi rrënjësisht, por në drejtim të mirë. Më parë motivimet tona kanë patur gjithmonë natyrë materiale, ndërsa këtu mund të arrijmë pavarësi të plotë materiale me ndihmën e njerëzve. Pamvarësisht nga lloji i sipërmarrjes apo sasisë të pronave, veç Foreverit asgjë nuk është garanci për atë, që edhe pas dhjetë vjetëve do të funksionojë po kaq mirë. Të kemi më shumë kujdes në zhvillimin tonë individual, për tu bërë njerëz më të mirë. Në mundësin e Foreverit është fantastike edhe ajo, që më në fund nisëm një sipërmarrje të tillë, ku mund të punojmë së bashku me burrin. Është e vërtetë çfarë thonë për ne: Foreverin sikur e kanë gjetur për ne.





EDHE NË GARAT E SPORTIT
– FITORE ME PRODUKTET

Mamaja ime, njëkohsisht edhe sponsorja ime, Annamária Szűcs, duke filluar që në moshë të vogël na ka edukuar për një mënyrë jetese aktive dhe të shëndetshme. Kështu deri ditën e sotme jemi pjesë e aktiviteteve sportive sistematike. Motra ime Kriszti merr pjesë ë garat e hipizmit, ndërsa unë që njëmbëdhjet vjeçe merrem me atletikë. Ushqehemi në mënyrë të shëndetshme, dhe krahas kësaj, falë vetëdijes të mamasë për shëndetin, kemi konsumuar edhe plotësues dietikë. Në Forever e shumta kam 5 vjet në saje të Tamás Budai (të cilit do ti jem mirënjohëse për jetë). Si sportiste e përfaqësueses organizmi im i është ekspozuar një ngarkesë të madhe: çdo javë me 6-8 stërvitje, nga janari deri në gusht, me një tension shpirtëror... dhe se di sa herë në njërën dorë kam qënë shumë sëmure në gjashtë vitet e fundit. Apo ajo që është më e rëndësishme sa herë jam dëmtuar fizikisht (një herë më rëndë), dhe të gjitha këto i kam përballuar në një masë të madhe falë edhe furnizimit të organizmit tim me lëndët e duhura ushqese.

Midis produkteve ka disa që personalisht i kam të preferuara. Në vend të parë vë Argi+. Para stërvitjes pi këtë ndihmues të forcimit të muskujve, si një preparat i përgatitur posaçërisht për sportistat, por edhe me një shije të veçantë. Përzierja e kremërave Heat Lotion dhe MSM Gel, është një një përzierje e shkëlqyer për masazh dhe për ushqyerje të lëkurës. Pijen FAB apo FAB-X dhe tabletat Gin-Chia i pi një deri dy orë para garës. Nga multivitamina e re Kids konsumoj një flakon çdo 2 javë, e adhuroj vecanrisht. Për sportistat konsumimin e tabletave të Echinacias e konsideroj të rëndësishme për gjatë gjithë vitit (kjo bimë medicinale figuron edhe në rekomandimin e mjekësisë sportive). Xheli Freedom, kapsulat e acidit hyularonik Active HA, Calciumi, produktet e bletës dhe tabletat me minerale Nature-Min për mua janë shumë të rëndësishme, veçanrisht në periudhën e stërvitjes bazë. Në garat jashtë vendit, apo në udhëtime disa ditore në rrethe, gjithmonë në çantën time do të gjejsh qeskat me lëngun aloe 2Go (natyrisht edhe kur nuk jam në udhëtim çdo ditë e filloj me pirjen e xhelit të aloes).

Por kjo është vetëm maja e akullnajës, në fakt përveç Vitolize Men, që është për meshkujt, sipas periudhave, apo vazhdimisht, konsumoj edhe produkte të tjera. Në sportin hungarez, dhe kryesisht në sportet e garave, mendoj se ka nevojë për një ndryshim mentaliteti dhe mënyre të menduari për forcimin e vetëdijes për shëndetin tek drejtuesit e sportit, trenerët dhe tek vetë sportistët, ku ashtu si edhe në familjen tonë këto produkte janë pjesë e perditshme.

Pas leksionit të Brian Tracy, në pranverë edhe mua më hyri në qejf ndërtimi i rrjeteve, dhe me sa shikoj, ky biznes ka nevojë edhe për shumë të rinj. Në moshën time ka shumë të paperspektivë, pas mbarimit të shkollës së mesme apo mbarimit të universitetit me çfarë do të merren dhe si do ta ndërtojnë jetën. Jam nga ato që dua atyre tu jap shembullin. Për këtë ndihmon shumë edhe sistemi i trainimit në Forever, që ofron mundësi të shkëlqyera zhvillimi edhe në fusha të tjera të jetës.

Si sportiste kam patur një ndihmë të fuqishme si nga firma nëpërmjet produkteve, ashtu edhe nga drejtuesit hungarezë. Në garat sportive unë kam përdorur logon e veçantë të Foreverit, për të cilën falnderoj drejtorin e pergjithshëm Dr Sándor Milesz dhe drejtoreshen e marketingut Bernadett Huszti si dhe stafin e tyre!

Zsanett Kenesei, atlete e distancave të mesme 22 herë pjesmarrëse në kampionatin hungarez dhe gjashtëmbëdhjet herë pjesmarrëse në përfaqësuesen hungareze, sivjet për herë të parë përfaqsoi skuadrën tonë në kampionatin europian të të rriturve. Krahas kësaj sivjet ka filluar vitin e fundit si studente e kinezçes në universitetin ELTE. Prej vitesh konsumon produkte të FLP, dhe që nga Trainimi i parë I Diamantëve të Foreverit, është e angazhuar në mënyrë aktive edhe me ndërtimin e biznesit. Dhe për këtë na tregon për rrugën e saj.



FOREVER

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk. **Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Zsuzsanna Petroczy Redaktor: Valéria Kismarton, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk. **Përkthim, redaktim:** Mímoza Borbáth, Xhelo Kicaj (shqip), Babity Gorán Vladimír, Žarko Anić Antić (kroat), Babity Gorán Vladimír, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (slloven). **Shtypshkronja:** Palatia Nyomda és Kiadó Shpk.

U përgatit në 30500 kopje. Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.foreverliving.com



smile